

RAPORT VJETOR

2021

AGJENCIA KOMBËTARE E RINISË



www.rinia.gov.al



info@rinia.gov.al

PËRMBAJTJE

1.	<i>FJALA E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM</i>	02
2.	<i>HYRJE</i>	04
2.1.	Misioni	04
2.2.	Fushat e Përgjegjësisë së AKR-së	04
2.3.	Kuadri Ligjor	05
2.4.	Struktura e Institucionit	06
3.	<i>VEPRIMTARIA DHE FUNKSIONET E AKR-SË.</i>	07
3.1.	Projekte Rinore	08
3.1.1.	Këshilli Kombëtar i Rinisë (KKR)	09
3.1.2.	Thirrja Nr.1 për Projektpropozime Rinore	10
3.1.3.	Procesi i Shqyrtimit të Aplikimeve dhe Subjektet Fituese të Thirrjes Nr. 1	10
3.1.4.	Lidhja e Kontratave dhe Monitorimi	12
3.2.	Programe dhe Aktivitete	13
3.2.1.	Të Rinjtë në Procese Vendimmarrëse dhe Demokratike	13
3.2.2.	Fuqizimi i Rinisë, Ngritje Kapacitetesh	14
3.2.3.	Aktivitete	16
3.2.4.	Bashkëpunime	17
3.2.5.	Vizibiliteti	18
3.3.	Menaxhimi Financiar	18
4.	<i>OBJEKTIVA 2022</i>	21

1. FJALA E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM



Përballja globale me COVID-19 dëshmoi se jetojmë në një epokë ndryshimesh të shpejta e të thella, duke impaktuar shoqëritë dhe duke u dashur të përqafojmë efekte dhe masa në dobi të mirëqënies dhe vijimësisë së integritit të shoqërisë në kushte të reja për të përballuar sfidat e përbashkëta. Kështu, edhe përgjatë vitit 2021, ende në ndikime ekonomike e sociale si pasojë e pandemisë, prioriteti ndaj rinisë shqiptare në drejtim të promovimit dhe aktivizimit të saj, hodhi themelet mbi të cilat Agjencia Kombëtare e Rinisë operon, si një institucion me përgjegjësinë e plotë në zbatim të politikave rinore në vend.

Agjencia u krijua si një mekanizëm i përmirësuar për të qenë më efikas kundrejt promovimit të të rinjve, adresimit të sfidave të përditshme, promovimit të tyre të mëtejshëm duke i konsideruar ata forcën dhe energjinë e vendit tonë drejt të ardhmes evropiane.

Me një nisje të thelluar drejt orientimit ndaj prioriteteve të rinisë, puna e dedikuar e Agjencisë u zgjerua duke ideuar programe dhe projekte në funksion të zbatimit të politikave kombëtare rinore duke patur gjithmonë në qendër të rinjtë, si një nga popullësitë me moshën më të re në Evropë.

Puna jonë përgjatë vitit 2021 u fokusua gjithashtu në parimin e bashkëpunimit dhe mbështetjes ndaj shoqërisë civile që punon çdo ditë me të rinjtë, por edhe ndaj njësive të vetëqeverisjes vendore për të përfshirë të rinjtë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Për sakaq, financimi i projekteve rinore, në shpalljen e thirrjes nr.1 për projektpropozime, jetësoi projekte në kuadër të fuqizimit të të rinjve drejt sipërmarrjes e inovacionit, vullnetarizmit dhe sportit, artit dhe kulturës, duke ofruar edhe mbështetje ndaj infrastrukturës rinore të njësive të vetëqeverisjes vendore të vendit.

Një pikë tjetër orientuese që do të vijojë nën frymën tonë bashkëpunuese dhe mbështetëse, ka qenë dhe mbetet ngritja e kapaciteteve rinore në njësitë e vetëqeverisjes vendore, në zbatim të ligjit të rinisë, si udhërrëfyes i punës tonë të përbashkët, por edhe në zbatim të rritjes së përfshirjes dhe angazhimit të të rinjve.

Progresi dhe adresimi i sfidave të përbashkëta nuk do të ishte i mundur pa mbështetjen e bashkëpunëtorëve tanë, të cilët përgjatë vitit 2021 kanë qenë të shumtë, duke përqafuar kështu misionin për të cilin është krijuar Agjencia por edhe idetë mbi të cilat ne kemi dashur të nisim rrugëtimin tonë.

Po ashtu, jetësimi i programeve dhe avancimi i ritmit të punës gjithmonë me dedikim e përkushtim në funksion të të rinjve, nuk do të ishte i mundur pa përkrahjen e stafit që punon çdo ditë në Agjencinë Kombëtare të Rinisë.

Besimplotë se gjatë vitit 2022 na presin projekte të bukura dhe sfida të ndryshme, angazhimi serioz dhe i përditshëm i Agjencisë Kombëtare të Rinisë do të vijojë të ndjekë ritme plot energji dhe punë të palodhur, sikurse karakterizohet rinia e vendit tonë.

Ju faleminderit!

Me respekt,
Kleina Kasanai





2. HYRJJE

Kush jemi ne?

Agjencia Kombëtare e Rinisë (këtu e në vijim referuar si AKR) është person juridik publik buxhetor, në varësi të Ministrit Përgjegjës për Rininë. AKR është institucion shtetëror që zbaton politikat rinore, siguron mbështetjen, përfshirjen e rinisë dhe pjesëmarrjen e tyre në jetën publike, sociale, ekonomike e kulturore në nivel kombëtar. Veprimtaria e saj shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe organizohet në nivel qendror. Qëllimi i këtij institucioni është mbrojtja e të drejtave të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse, krijimi i kushteve të nevojshme për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve si dhe bashkëpunimi me organizatat që ushtrojnë veprimtari në fushën e rinisë.

2.1 Misioni

Misioni i AKR-së është garantimi i mbrojtjes dhe i promovimit të të drejtave të të rinjve, nëpërmjet mbështetjes së edukimit joformal, ndërveprimit e aktivizimit të rinisë dhe financimit të veprimtarive rinore, në zbatim të politikave shtetërore në fushën e rinisë.

2.2 Fushat e Përgjegjësisë së AKR-së:


- 1 mbështetje për edukim joformal;
- 2 ndërveprim dhe aktivizim i rinisë;
- 3 financim i veprimtarive rinore.

2.3 Kuadri ligjor

AKR zhvillon veprimtarinë e saj në bazë dhe për zbatim të kuadrit ligjor të mëposhtëm:

- ➔ Ligjit Nr. 75/2019 “Për Rininë”;
- ➔ Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 681, datë 02.09.2020 “Për mënyrën e krijimit, të organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë (AKR)”;
- ➔ Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 969 datë 02/12/2020, “Për përcaktimin e kriterëve e të procedurave të zgjedhjes së anëtarëve të këshillit kombëtar të rinisë, si dhe të mënyrës së organizimit e të funksionimit të tij;
- ➔ Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1141, datë 24.12.2020, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë, që përfitojnë financim nga fondet grant nga buxheti i shtetit të dedikuar për rininë”;
- ➔ Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 274, datë 12.05.2021 “Për përcaktimin e kriterëve që duhet të përmbush Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore”;
- ➔ Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 833 datë 24.12.2021 “Për mënyrën e ngritjes, administrimit, mirëmbajtjes së bazës së të dhënave për rininë si dhe mënyrën e ndërveprimit të saj me bazat e tjera të të dhënave shtetërore”;
- ➔ Urdhër i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 76 datë 21.04.2021 “Për emërimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Rinisë (KKR)”;
- ➔ Urdhër i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr.168 datë 18.06.2021 “Për ngritjen e Bordit Përzgjedhës të projekteve që përfitojnë mbështetjen financiare nëpërmjet fondit grant të dedikuar për rininë”;
- ➔ Urdhër i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 33 datë 28.06.2021 “Për miratimin e dokumentacionit, procedurës dhe hapjen e thirrjes së l-rë publike për financimin e projekteve rinore të propozuara nga organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore”;
- ➔ Urdhër i Kryeministrit Nr. 153 datë 30.12.2021 “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029 dhe të Planit të Veprimit 2022-2024”.

2.4 Struktura e Institucionit



Struktura e AKR-së është miratuar me urdhër të Kryeministrit nr. 163, datë 14.12.2020 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Rinisë”, dhe është e organizuar si më poshtë:

Drejtori i Përgjithshëm është autoriteti më i lartë ekzekutiv dhe e përfaqëson institucionin në çdo nivel organizimi dhe drejtimi. Ai siguron realizimin e objektivave dhe përgjigjet para Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, për gjithë aktivitetin e AKR-së në përputhje me misionin e tij.

Struktura e AKR-së përbëhet nga tre sektorë të cilët varen dhe raportojnë para Drejtorit të Përgjithshëm: Sektori i Projekteve Rinore, Sektori i Programeve, Bashkëpunimit, Komunikimit dhe Statistikës, si dhe Sektori Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Sektori i Projekteve Rinore ka për detyrë të ndjekë dhe të mbikëqyrë projektet e financuara nga AKR, të mbikëqyrë zbatimin e projekteve brenda afateve të paracaktuara, të raportojë tek Drejtori i Përgjithshëm për mbarëvajtjen e çdo projekti brenda afateve të caktuara, të hartojë raportet për çdo projekt të financuar nga AKR dhe t’ia përcjellë Drejtorit të Përgjithshëm etj.

Sektori i Programeve, Bashkëpunimit Komunikimit dhe Statistikës ka për detyrë të implementojë politikat dhe programet për rininë, mbledhë dhe administrojë të dhënat mbi situatën e të rinjve në bashkëpunim me institucionet e tjera dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, të bashkëpunojë me organizma, institucione, donatorë dhe subjekte të tjera, vendase dhe/ose të huaja, për prezantimin dhe zbatimin e politikave, programeve dhe veprimtarive rinore etj.

Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse menaxhon burimet njerëzore, çështjet ligjore, mirëmbajtjen dhe shërbimet e tjera mbështetëse, zbaton dhe administron buxhetin, mban kontabilitetin, monitoron respektimin e kriterëve ligjore për kryerjen e veprimtarive rinore etj.

3. VEPRIMTARIA DHE FUNKSIONET E AKR-SË.

Ligji për Rininë lindi si nevojë për të pasur një rregullator, i cili do të garantonte mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse, si dhe krijimin e kushteve të nevojshme për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve. Ndër të tjera, ky ligj përcakton fushën e përgjegjësisë së AKR-së, si institucioni i cili zbaton politikat dhe programet për të rinjtë. Në bazë dhe për zbatim të ligjit për Rininë dhe VKM-së që rregullon organizimin dhe funksionimin e AKR-së, kjo e fundit ushtron veprimtarinë e saj në mbështetjen e të rinjve në edukimin jo-formal, ndërveprimin dhe aktivizimin e tyre, si dhe financimin e veprimtarive rinore. AKR shtrin kompetencën në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke synuar mbështetje në ngritjen e kapaciteteve, ndërveprimin e të rinjve në komunitetin ku jetojnë dhe përmirësimin e aftësive të të rinjve në fushën kulturore, artistike, letrare, sportive etj. Këto synime kërkohen të arrihen duke përfshirë, financimin e projekteve për të rinjtë, takimet dhe fushatat informuese e ndërgjegjësuere, konferencat, përfshirjen e të rinjve në jetën sociale, trajnimet teknike etj.

Përgjegjësitë e AKR-së përfshijnë, por pa u kufizuar:

- Mbështetjen, nxitjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve;
- Sigurimin e kushteve të duhura për rritjen e ndërgjegjësimin nga subjekte vendase dhe të huaja;
- Nxitjen dhe zhvillimin e dialogut të strukturuar, për përfshirjen e sa më shumë palëve, me synim fuqizimin e pozitës së të rinjve në shoqëri;
- Krijimin e mekanizmave për zhvillimin dhe nxitjen e politikave rinore, si dhe marrjen e vendimeve profesionale, cilësore e të pavarura, në përzgjedhjen e programeve dhe projekteve të financuara nga buxheti i shtetit.



3.1 Projektet Rinore

ADMINISTRIM, FINANCIM, KOORDINIM DHE MONITORIM I PROJEKTEVE RINORE

Nëpërmjet fondit grant të dedikuar për rininë, AKR-ja financon projektet rinore të organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë, apo njësitë e vetëqeverisjes vendore. Projektet rinore të financuara nga Thirrja nr. 1 për projektpropozime rinore, përfshijnë fusha të ndryshme mbi teknologjinë e sipërmarrjen, nxitjen e edukimit artistik dhe sportiv, fuqizimin e të rinjve pas pandemisë Covid-19, si dhe rikthimin e vëmendjes ndaj artizanatit etj. Gjithashtu janë financuar njësitë e vetëqeverisjes vendore në përmirësimin e infrastrukturës rinore vendore, me synimin e një impakti direkt në ofrimin e shërbimeve ndaj të rinjve në nivel vendor.

Në thirrjen e parë të financimit të projekteve rinore, AKR-ja ka dhënë mbështetjen e saj duke financuar organizatat rinore, organizatat për të rinjtë si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, me qëllim përmirësimin e jetës së të rinjve qoftë në aspektin sasior dhe atë cilësor.

AKR, nëpërmjet një procesi transparent, inkurajoi të treja subjektet e sipërpërmendura (organizatat rinore, organizatat për të rinjtë si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore) të aplikonin në Thirrjen nr.1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore u ftuan për aplikim lidhur me financimin e ndërtimit apo të rikonstruksionit të objekteve publike dhe të infrastrukturës rinore, ndërsa organizatat rinore dhe për të rinjtë mbi prioritetet e mëposhtme:

- Inovacioni dhe sipërmarrja;
- Vendimmarrja dhe gjithëpërfshirja;
- Edukimi jo-formal;
- Përfshirja sociale.

Thirrja nr. 1 për Projektpropozime Rinore ka kaluar në fazat e mëposhtme:

- Konstituimi i Këshillit Kombëtar të Rinisë (KKR);
- Hapja e thirrjes Nr.1 për Projektpropozime Rinore;
- Procesi i Shqyrtimit të Aplikimeve dhe Subjektet Fituese të Thirrjes Nr. 1;
- Lidhja e Kontratave dhe Monitorimi.

3.1.1 Konstituimi i Këshillit Kombëtar të Rinisë (KKR)

KKR, si organ këshillimor që funksionon pranë Ministrit Përgjegjës për Rininë, propozon drejtimet dhe programet kryesore për mbështetjen dhe fuqizimin e pjesëmarrjes së të rinjve, jep mendim në hartimin e Strategjisë Kombëtare për Rininë, si dhe monitoron zbatimin e saj. AKR ka shpallur thirrjen për kandidim, më datë 29 Janar 2020, me qëllim themelimin e KKR-së konform procedurës, kriterëve dhe kuotës gjinore.

Thirrja për kandidatët u publikua në faqen zyrtare të AKR-së dhe qëndroi e hapur për një periudhë prej 30 ditësh. Pas përfundimit të kësaj periudhe është shqyrtuar dhe bërë vlerësimi nga grupi i punës së AKR-së i kandidaturave të cilat plotësuin kriteret dhe dokumentacionin sipas legjislacionit në fuqi.

Në vijim, këto kandidatura janë shpallur për votimin elektronik për një periudhë 10 ditore ku organizatat dhe studentët, në një proces transparent kanë zgjedhur anëtarët, emrat e të cilëve janë publikuar në faqen zyrtare të AKR-së dhe janë emëruar me Urdhër të Ministrit Përgjegjës për Rininë, më datë 21 Prill 2021. KKR mbështetet nga Sekretariati Teknik, strukturë me një përbërje prej 3 anëtarësh.

Programi Vjetor i Financimit dhe Skema e Shpërndarjes së Fondit Grant, sipas konsultimit me KKR-në, është propozuar nga AKR, datë 12 Maj 2021, miratuar nga Ministri Përgjegjës për Rininë, datë 02 Qershor 2021.



3.1.2 Hapja e Thirrjes Nr.1 për Projektpropozime Rinore

Thirrja nr.1 për projektpropozime rinore u hap ne datën 28 Qershor 2021 deri më 12 Gusht 2021. Kjo thirrje pati një interes të gjerë si nga organizatat rinore, organizatat për të rinjtë ashtu edhe nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, me një numër total prej 95 aplikimesh, respektivisht 66 projektpropozime nga organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë dhe 29 projektpropozime nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

AKR, si autoritet financues, nëpërmjet fondit grant të dedikuar për rininë, miratuar në ligjin vjetor të buxhetit, financon projektet e propozuara nga organizatat rinore, dhe/ose për të rinjtë si edhe njësitë e vetëqeverisjes vendore. Programi Vjetor i Financimit dhe Skema e Shpërndarjes së Fondit Grant, janë shpallur në faqen zyrtare të internetit. AKR-ja ka hartuar dhe publikuar Thirrjen nr. 1 më datë 28 Qershor 2021 dhe ka vendosur në dispozicion të të gjithë kandidatëve të interesuar dokumentet e konkurrit për projektpropozime rinore.

Thirrja nr. 1 ka qëndruar e hapur për 45 ditë kalendarike. Gjatë periudhës së aplikimit janë zhvilluar sesionet informuese në lidhje me Thirrjen nr. 1 për organizatat rinore, dhe/ose për të rinj si dhe për njësitë e vetëqeverisjes vendore, për të qartësuar dhe sqaruar procesin për të gjithë kandidatët.

3.1.3 Procesi i Shqyrtimit të Aplikimeve dhe Subjektet Fituese të Thirrjes Nr. 1

Procesi i shqyrtimit dhe përzgjedhjes së subjekteve përfituese, është zhvilluar në dy faza nga AKR-ja dhe Bordi Përzgjedhës i Projekteve, mbështetur nëparimet e më poshtme:

- a) Liria në pjesëmarrje dhe konkurrim;
- b) Mosdiskriminimi dhe trajtimi i barabartë;
- c) Transparenca e procedurave dhe e vendimmarrjes;
- d) Përputhshmëria me objektivat e grantit dhe efektiviteti i përdorimit të burimeve;
- e) Mungesa e prapaveprimit;
- f) Paanshmëria e shqyrtimit dhe e vendimmarrjes.

AKR-ja ka administruar aplikimet e organizatave rinore, dhe/ose për të rinjtë, si dhe të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe është hartuar lista e projektpropozimeve të cilat kanë plotësuar kriteret dhe respektuar parimet, brenda 30 ditëve kalendarike nga afati i fundit i dorëzimit. Lista e projektpropozimeve, administruar nga AKR-ja i është përcjellë Bordit Përzgjedhës të Projekteve, i cili ka bërë përzgjedhjen e projekteve fituese.

Vlerësimi i Bordit Përzgjedhës të Projekteve është mbështetur në qëllimin dhe kapacitetin e aplikantit, efektshmërinë e aktiviteteve, pritshmërinë dhe koston e tyre duke synuar zgjerimin e impaktit në disa fusha si: sporti, artet, zanatet tradicionale, kurse profesionale, edukimi joformal, sipërmarrja, inovacioni, sfidat dhe mundësitë pas pandemisë. Subjektet fituese të Thirrjes nr. 1 për projektpropozime rinore, në përputhje me Vendimin e Bordit Përzgjedhës së Projekteve, janë njoftuar për nisjen e fazës së negocimit të projekt-buxheteve. Vlerat përfundimtare të financimit, pas zhvillimit të fazës së negocimit përgjatë muajit Tetor 2021, me secilin nga subjektet fitues janë pasqyruar në tabelat vijuese:

	ORGANIZATA RINORE DHE PËR TË RINJTË	BUXHETI
1	Federata Shqiptare e Sportit Universitar	2,600,000 (dy milion e gjashtëqind mijë) lekë
2	Fondacioni Qendra Europiane & Qendra Be the Change	2,300,000 (dy milion e treqind mijë) lekë
3	Instituti Adriapol - Smart and Creative Development	2,832,530 (dy milion e tetëqind e tridhjetë e dy mijë e pesëqind e tridhjetë) lekë
4	Shoqata Liburnetik	2,600,000 (dy milion e gjashtëqind mijë) lekë
5	Shoqata Tjetër Vizion	2,497,000 (dy milion e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë) lekë
6	Shoqata e Ushqimit dhe Mirëqënies	2,642,000 (dy milion e gjashtëqind e dyzetë e dy mijë) lekë
7	Organizata “Resurset në Zhvillim”	2,745,000 (dy milion e shtatëqind e dyzetë e pesë mijë) lekë
8	Organizata “The Door”	2,799,800 (dy milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind) lekë

9	Qendra Multifunctional Cultural Center A.M Swans	2,673,650 (dy milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë
10	Qendra Epoka e Re	998,700 (nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind) lekë
11	Qendra Shkencë dhe Inovacion_ SCiDEV	2,516,000 (dy milion e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë) lekë;
12	Qendra për Edukim dhe Sport Skills	1,518,000 (një milion e pesëqind e tetëmbëdhjetë mijë) lekë

	NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE	BUXHETI
1	Bashkia Tiranë	3,186,489 (tre milionë e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë.
2	Bashkia Lezhë	8,541,077.6 (tetë milion e pesëqind e dyzetë e një mijë e shtatëdhjetë e shtatë pikë gjashtë) lekë.
3	Bashkia Roskovec	1,905,443 (një milion e nëntëqind e pesë mijë e katërqind e dyzetë e tre) lekë.
4	Bashkia Elbasan	5,503,842 (pesë milion e pesëqind e tre mijë e tetëqind e dyzetë e dy) lekë.

3.1.4 Lidhja e Kontratave dhe Monitorimi

AKR, gjatë muajit Nëntor 2021, nënshkroi kontratat me secilin nga subjektet fituese, sipas vlerave të paraqitura në tabelat 1.1 dhe 1.2. Kontrata përcakton mënyrën e transferimit të fondit, dokumentacionin, raportimin, llojin e shpenzimeve të njohura, dokumentimin e tyre, format e kontrollit, kushtet dhe përgjegjësitë e palëve etj. Pas nënshkrimit të kontratës, u realizua kalimi i kështit nr. 1 të buxheteve të projekteve, për llogari të subjekteve të shpallura fituese.

Projektet fituese janë në fazën e implementimit. AKR ndjek dhe monitoron implementimin e projekteve fituese, të 12 (dymbëdhjetë) organizatave dhe 4 (katër) njësi të vetëqeverisjes vendore deri në realizimin me sukses të tyre.

3.2 Programe dhe Aktivitete

Plani i punës së AKR-së, në mbështetje të të rinjve, në kuadër të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të tyre është ambicioz, me objektiva dhe indikatorë për të gjeneruar mbështetje, koordinim dhe bashkërendim të prioritetëve, aktiviteteve dhe takimeve të përbashkëta promovuese mes aktorëve kryesorë. AKR-ja përgjatë vitit 2021 ka punuar mbi një sërë programesh, aktiviteteve dhe bashkëpunimesh në funksion të fuqizimit të të rinjve. Më konkretisht, programet dhe aktivitetet e AKR-së fokusohen në këto drejtime: të rinjtë në procese vendimmarrëse dhe demokratike, fuqizimi i inisë, ngritje kapacitetesh, aktivitete, bashkëpunime etj.



3.2.1 Të Rinjtë në Procese Vendimmarrëse dhe Demokratike

AKR-ja synon të rrisë në nivel kombëtar pjesëmarrjen e të rinjve në proceset vendimmarrëse dhe ato demokratike. Gjithashtu, një ndër objektivat e këtij institucioni është edhe mobilizimi i rinisë në pjesëmarrje, përfaqësim dhe qytetari aktive. Për të realizuar këto synime, AKR-ja ka zhvilluar një sërë takimesh informuese në njësitë e vetëqeverisjes vendore në lidhje me prezantimin e AKR-së dhe krijimin e një rrjetëzimi mes tyre dhe organizatave lokale, me qëllim bashkëpunimin dhe forcimin e kapaciteteve rinore. Gjatë vitit 2021 janë realizuar një sërë takimesh në qarqe të ndryshme të Republikës së Shqipërisë, me fokus kryesor mbështetjen në procedurën e krijimit të KVR-ve në vend.

AKR-ja është përpjekur të jetë urë lidhëse, duke lehtësuar bashkëpunimet mes njësive të vetëqeverisjes vendore, organizatave rinore dhe për të rinjtë, me qëllim zhvillimin e kapaciteteve, infrastrukturave dhe hapësirave të sigurta rinore. AKR-ja në Janar të vitit 2021, ndërmori iniciativën për të kontribuar në përmirësimin e klimës së bashkëpunimit me qendra rinore/kulturore/organizata për të rinj. Janë zhvilluar takime prezantimi me kreatorë të këtyre hapësirave multifunkionale të shtrira në mbarë vendin, duke u ofruar gatishmërinë për mbështetje dhe bashkëpunime dypalëshe në të ardhmen.

Afrimi i të rinjve drejt vullnetarizmit është parë me rëndësi duke nxitur angazhimin, solidaritetin dhe kontributin personal në komunitetin ku ata jetojnë. AKR, bazuar në takimet e vazhdueshme me grupet e interesit, ka kuptuar rëndësinë e zhvillimit dhe gjallërimit të mëtejshëm të programeve të përbashkëta, mënyrën e angazhimit të të rinjve drejt shtresave në nevojë, ndërgjegjësimin dhe kontributin në mbrojtjen e mjedisit, emergjencat civile si COVID 19 etj, ku me dëshirë e përkushtim janë aktivizuar të rinjtë.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe raportit mes të rinjve dhe artit e kulturës. Këto të fundit, janë thelbësorë në edukimin dhe mbështetjen që i japin zhvillimit tërësor të çdo individi, veçanërisht të rinjve. Takimet në qendra me fokus social-kulturor-artistik, kanë dhënë mundësinë të njihen nga afër të rinjtë që zgjedhin ta shpenzojnë kohën e lirë duke u zhvilluar si dhe të identifikohen talente të shumtë. AKR-ja ka siguruar mbështetje për promovim dhe angazhim të mëtejshëm të të rinjve në aktivitete sociale-kulturor-artistike.


Në një botë e cila po zhvillohet me ritme të shpejta, në fushën e teknologjisë dhe inovacionit, aftësitë digjitale nuk janë më thjesht një pasion i momentit, por janë një prioritet për të rinjtë drejt mundësive të zhvillimit personal dhe atij profesional. Të shumta kanë qenë qendrat inovatore që janë vizituar përgjatë vitit 2021. Këto qendra synojnë të zhvillojnë aftësitë krijuese dhe analitike të të rinjve në fusha të ndryshme si: programim, dizënjim grafik, robotikë etj.

Edukimi profesional nënkupton ruajtjen dhe zhvillimin e njohurive, aftësive dhe përvojave në lidhje me aktivitetet profesionale të të rinjve. AKR-ja i ka kushtuar rëndësi të madhe edukimit profesional duke i vizituar nga afër, si dhe është takuar me përfaqësues/drejtues e të rinj që janë në ndjekje të vazhdueshme të kurseve të ndryshme që këto qendra ofrojnë. Takimet kanë shërbyer për t'u njohur me lehtësirat që ofrojnë qendrat për të rinjtë, të cilët kanë zgjedhur shkollat profesionale për të përvetësuar profesione të caktuara dhe për të qenë të përgatitur drejt tregut të punës. AKR-ja është gjithmonë në mbështetje të tyre dhe e gatshme për bashkëpunime në të ardhmen.

3.2.2 Fuqizimi i Rinisë, Ngritje Kapacitetesh

Fuqizimi i rinisë, mbështetja dhe ngritja e kapaciteteve të të rinjve, promovimi dhe pasqyrimi i arritjeve të tyre duke i stimuluar dhe prezantuar si modele suksesi, ka qënë padyshim ndër objektivat e AKR-së. Me qëllim arritjen e këtyre objektivave, AKR -ja ka ndërmarrë nismën “#iRiuiMuajit”, një rubrikë që promovon modele suksesi, si dhe të rinj të talentuar nga fusha të ndryshme të sportit, artit, edukimit, kulturës, shkencave ekzakta si dhe pa harruar të rinjtë me aftësi ndryshe. Çdo muaj një i ri është promovuar në rrjetet tona sociale duke përshkruar arritjet dhe moton e tij. Në kuadër të “Ditës Kombëtare të Rinisë” të gjithë të rinjtë e përzgjedhur u bënë bashkë në fund të vitit në një mbrëmje gala për të festuar arritjet dhe sukseset e tyre.

Profilat e të rinjve që spikatën gjatë këtij viti i gjeni të përmbledhura në këtë grafik:



AKR-ja ka ndjekur nga afër të rinj të talentuar që kanë spikatur në fusha të ndryshme si dhe të rinj me arritje të shkëlqyera në rezultate mësimore dhe jo vetëm, ka promovuar të rinj me potencial të jashtëzakonshëm për të inspiruar dhe inkurajuar të rinj të tjerë. Kjo formë motivimi shërben për të identifikuar të rinjtë, si dhe për të mbështetur zhvillimin e aftësive të tyre për ti vënë ato në shërbim të komunitetit. Me punën e tyre ata kanë spikatur si ideues të platformave, falë ideve që kanë lindur për t'u ardhur në ndihmë nevojave të tyre apo bashkëmoshatarëve. Shumë të rinj kanë arritur sukses të përkthyer në medalje të nivelit kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e sportit, pa lënë pas dore dhe shumë të tjerë që promovojnë bukuritë natyrore të Shqipërisë. Punët kreative, arti i mirëfilltë dhe “street art” nga të rinjtë janë mbështetur dhe vlerësuar nga AKR-ja përgjatë këtyre takime. Të rinjtë krijues e inovatorë kanë nevojë të motivohen dhe përkrahen vazhdimisht në nismat e tyre duke rritur kështu vetëbesimin për të qenë ata forca që do të përshpejtojë progresin drejt Shqipërisë së gjeneratës tjetër.

Fuqizimi i të rinjve dhe ngritja apo zhvillimi i kapaciteteve, synon të ndërgjegjësojë, zhvillojë, edukojë dhe përmirësojë cilësinë e jetës së të rinjve në nivel kombëtar. Një nga aktivitetet më dinamike dhe interaktive ishte realizimi i Shkollës Verore “RinCamp”, me mbështetjen e UNFPA, UNICEF dhe World Vision Albania. Pjesëmarrës të kësaj shkolle katër ditore ishin të rinjtë me kontrata 1-vjeçare pune pranë Administratës Publike. Ky aktivitet kishte si qëllim aftësimin e të rinjve me njohuri teknike të nevojshme dhe profesionale në punët e ndryshme që përfshijnë administratën publike, promovimin e një pune cilësore sipas standardeve evropiane, promovimi i bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes rinore në jetën e komunitetit.

AKR-ja, në vazhden e punës për zhvillim kapacitetesh dhe fuqizimin e të rinjve, zhvilloi Shkollën Dimërore “Rinia në Politikë Vendore”. Me mbështetjen e World Vision Albania. Shkolla Dimërore, u konceptua si aktivitet trajnues i të rinjve pjesëmarrës për ngritjen e strukturave të rinisë dhe fuqizimin e personave përgjegjës për rininë pranë 61 bashkive të vendit. Qëllimi i shkollës ishte krijimi i urave të komunikimit midis përfaqësuesve të bashkive, duke shkëmbyer eksperiencë dhe ide në realizimin e procesit të ngritjes së KVR-ve, si një vëmendje e shtuar në politikë vendore në mbështetje të të rinjve.



3.2.3 Aktivitete

Aktivitetet e zhvilluara nga AKR-ja gjatë vitit 2021, kanë pasur si qëllim ndërgjegjësimin e rinisë, edukimin dhe përmirësimin e qasjes së tyre ndaj kauzave sociale të rëndësishme, rritjen e pjesëmarrjes në jetën sociale si dhe nxitjen e frymës së bashkëpunimit në art dhe kulturë. Në mënyrë periodike janë zhvilluar aktivitete që kanë pasur në fokus ndërgjegjësimin e të rinjve për çështje të ndryshme si p.sh: mjedisi, sporti, kultura etj. Përfshirja e grupeve të marginalizuara nëpërmjet pjesëmarrjes në aktiviteteve të ndryshme ka qenë gjithashtu një fokus i rëndësishëm i veprimtarisë sonë.

Barazia gjinore, përfshirja e grave dhe vajzave në proceset politike, fuqizimi i tyre në rrugëtimet personale dhe profesionale, sfidat me të cilat përballen ato sot si dhe arritjet e secilës prej tyre si model frymëzimi, kanë qenë kryefjalë e shumë aktiviteteve tona, në qëllim të mbështetjes së rrugëtimit dhe sipërmarrjeve të tyre.

Risjellja e vëmendjes ndaj librit të të rinjtë ka qenë një nga qëllimet tona duke synuar ti shkëpusim sado pak nga drejtimi drejt jetës digjitale të krijuar përgjatë periudhës COVID-19 dhe nënvizuar rëndësinë dhe impaktin që ka libri.

Edukimi dhe formimi profesional, si një domosdoshmëri për tregun e punës, ka bërë bashkë përfaqësues të institucioneve dhe të AKR-së së bashku me të rinj për t'u njohur dhe prezantuar mbi programet e punësimit dhe mundësitë që këto mekanizma ofrojnë. Modele inspiruese të fushave të ndryshme janë sjellë si formë motivimi për të rinjtë duke i orientuar ata drejt inovacionit, mendimit kritik, si dhe rrugës së suksesit në sipërmarrje.

AKR-ja gjithashtu ka mbështetur nisma sensibilizuese ndaj njerëzve në nevojë, veprimtari artistike, shkëmbime kulturore duke edukuar përmes artit dhe kulturës, të cilat kanë përfshirë të rinj nga Shqipëria dhe Kosova.





3.2.4 Bashkëpunime

AKR-ja, përgjatë vitit 2021 ka pasur në fokus bashkëpunimin me institucione, donatorë dhe subjekte të tjera, vendase ose të huaja, për prezantimin dhe zbatimin e politikave, programeve dhe veprimtarive rinore. Angazhimi ynë i përbashkët në drejtim të përmirësimit të cilësisë së jetës së të rinjve dhe forcimit të statusit të tyre, do të sjellë rezultate në avancimin e çështjeve me prioritet për të rinjtë e të rejtat në vendin tonë. Për këtë arsye janë zhvilluar takime me donatorë potencialë si Fridrich Ebert Stiftung, Konrad Adenauer Stiftung, World Vision, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Partners Albania etj, për të bërë të mundur investime dhe bashkëpunime në sektorin e rinisë. Nënshkrimi i Marrëveshjeve të Bashkëpunimit me Agjencinë Kombëtare të Diasporës dhe Westminster Foundation for Democracy zyrtarizojnë bashkëpunime me fokus të rinjtë dhe ndërlidhjen më të mirë të veprimtarive të përbashkëta me të njëjtin fokus. Gjithashtu, nëpërmjet Marrëveshjeve të Bashkëpunimit me Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës dhe Albanian University në Tiranë, të rinj studentë kanë patur mundësinë të kryejnë praktika pune pranë AKR-së, si një mundësi e mirë jo vetëm për të realizuar këto praktika, por për të njohur nga afër institucionin publik dhe funksionimin e AKR-së.

AKR ka qenë e pranishme dhe mjaft aktive në tryeza diskutimesh me bashkëpunëtorë të rëndësishëm si RCC, UNFPA, EU Policy Hub etj, me qëllim sigurimin e përmirësimeve afatgjata në kuadër të politikave rinore, diskutime mbi çështjet që lidhen me tregun e punës dhe kërkesat që ai parashtrohet në procesin e adaptimit/integrimit me strukturat e Bashkimit Evropian, metodologjinë që do të ndiqet nga vendet e Ballkanit Perëndimor në parandalimin, identifikimin dhe trajtimin e problemeve të shëndetit mendor tek të rinjtë. Në vazhdimësi të bashkëpunimeve, AKR-ja së bashku me rrjetin POP nëpërmjet financimit të Olof Palme International Center, ka krijuar "Manualin për Ngritjen e Këshillave Vendorë Rinorë pranë Bashkive". Ky manual shërben si udhërrëfyes për procesin e ngritjes dhe funksionimit të Këshillave Vendorë Rinorë.

Nëpërmjet këtyre bashkëpunimeve, ne synojmë zhvillimin e politikave rinore përmes rritjes së pjesëmarrjes së të rinjve në jetën publike dhe në vendimmarrje, rritjes së mundësive për punësim, përmirësimin e legjislacionit dhe të infrastrukturës në shërbimin e tyre, fuqizimit dhe përfshirjes së të rinjve në programet kombëtare dhe ndërkombëtare, në rrjetet e shkëmbimit të eksperiencave evropiane, në iniciativat vullnetare rajonale e botërore, nisma rinore sociale dhe akademike.

Është e rëndësishme të përmendet se AKR është pjesë e grupit të punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë për vitin 2022-2029 dhe Planit të Veprimit 2022-2024, të cilët do të shërbejnë si udhërrëfyes e instrumente kyçe në zhvillimin e zbatimit të politikave rinore në vend, por edhe në dhe vijimësinë e punës së AKR-së, duke kontribuar fuqimisht në këtë drejtim.

Ndër të tjera, AKR gjithmonë ka vlerësuar bashkëpunimin por edhe mbështetjen konkrete kundrejt jo vetëm iniciativave apo nismave të ardhura nga shoqëria civile apo bashkëpunëtorë të ndryshëm, por edhe ato të vetë të rinjve, të cilat gjithmonë janë karakterizuar nga qasja inovative dhe produktive.

3.2.5 Vizibiliteti

Faqja Web e AKR-së dhe rrjetet sociale u panë si një domosdoshmëri për të sjellë e ndarë në mënyrë transparente informacione të vlefshme dhe si formë interaktive dhe urë lidhëse midis AKR-së dhe të rinjve, organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve publike. AKR ka publikuar çdo informacion të dobishëm mbi thirrjet për projektpropozime rinore, konkurse brenda dhe jashtë territorit, shkëmbime social-kulturore por edhe promovime të të rinjve të cilët nëpërmjet ideve, dëshirës, këmbënguljes u bënë shembuj frymëzimi për bashkëmoshatarët e tyre dhe modele suksesi për punën e AKR-së.




3.3 Menaxhimi Financiar/Zbatimi i Buxhetit

AKR-ja disponon një fond buxheti i cili përcaktohet në buxhetin vjetor të shtetit. AKR-ja mund të përdorë dhe burime të tjera financimi si donacionet apo sponsorizimet për realizimin e politikave, programeve dhe projekteve rinore.

Nëpërmjet fondit grant të dedikuar për rininë, AKR-ja financon projektet e propozuara nga organizatat rinore, dhe/ose për të rinjtë apo njësitë e vetëqeverisjes vendore. Bazuar në paketën ligjore të miratuar në kuadër të përballimit dhe kapërcimit të situatës së shkaktuar nga Covid-19 si dhe lidhur me ndryshimet në Buxhetin e Shtetit 2020, u reduktuan fondet nga buxheti i AKR -së dhe i kaluan Aparatit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Hartimi dhe detajimi i buxhetit për shpenzimet u krye në funksion të përmbushjes së objektivave të AKR-së. Ky buxhet është detajuar në fillim të vitit por duke marrë në konsideratë ndryshimet e bëra në buxhetin e vitit 2021 edhe në përshtatje të kushteve të reja, u realizuan shpenzimet korrente dhe kapitale siç paraqiten në grafikun e mëposhtëm.

ZERI	LLORARIA	PLAN	FAKT	NE %
Paga	600	20,300	15,131	75
Sigurime Shoqërore	601	3,369	2,482	74
Mallra dhe Shërbime	602	6,600	3,543	54
Transferta korrente të brendshme	604	50,700	31,584	62
Transferta korrente të jashtme	605	20,400	20,384	100



Parashikimi në fillim të vitit për paga dhe sigurime u realizuan përkatësisht në masën 75% dhe 74%.

Për sa i përket shpenzimeve korrente, ato u realizuan në masën 54%. Ky realizim jo i plotë i këtyre shpenzimeve vjen si rrjedhojë e pandemisë Covid-19, për shkak se disa nga aktivitetet në 6 – mujorin e parë të vitit me shumë pjesëmarrës nuk u realizuan.

Zëri “Transferta të brendshme korrente” është realizuar në masën 62%. AKR-ja, në vitin e parë pas ristrukturimit të institucionit, sipas të cilit u zgjerua veprimtaria me financimin e projekteve rinore, respektoi me rigorozitet dhe sipas afateve procesin e diktuar nga legjislacioni në fuqi, duke themeluar KKR-në dhe hartuar dokumentacionin e nevojshëm në kuadër të thirrjes nr. 1 për projektpropozime rinore, e cila u shpall në Qershor të vitit 2021.

Janë përmbyllur dhe rakorduar me Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit Pasqyra Financiare e vitit 2020, të gjitha pasqyrat e tjera financiare sipas formateve të kërkuara dhe janë realizuar gjatë vitit rakordimet me thesarin për të gjitha shpenzimet e realizuara sipas muajve.

Realizimi i hartimit të Planit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023 në përputhje me nevojat e institucionit sipas hapave dhe procedurave të miratuara në to. Janë planifikuar nevojat për mbështetje financiare, në funksion të përmbushjes së misionit të AKR -së për realizimin e objektivave afatshkurtra e afatmesme, mbi baza produktesh.

Gjatë vitit 2021, plotësimi i nevojave institucionale për mallra dhe shërbime u realizua përmes procedurave të prokurimit publik në bazë dhe për zbatim të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2020 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe akteve të tjera ligjore në fuqi. Hartimi i pyetësorit të vetëvlerësimit për komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit (MFK). Hartimi i “Strategjisë së Menaxhimit të Riskut” duke realizuar identifikimin, vlerësimin, adresimin dhe regjistrin e riskut.



4. OBJEKTIVA

Viti i parë i punës së AKR-së, ka dhënë rezultate pozitive të matshme në drejtim të zbatimit të politikave rinore. Bashkëpunimi i ngushtë me të rinjtë, organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet që kanë në fokus rininë, qasja e përmirësuar ndaj problemeve në këndvështrimin e tyre, kanë qenë dhe do të vijojnë të jenë në qendër të punës së përditshme të AKR-së. Pandemia dhe viti i vështirë që kaluam në 2020-tën, na çoi drejt vitit 2021 me nevoja të reja duke u përshtatur me ndryshimet e domosdoshme. Teknologjia mori një vëmendje të madhe dhe u kuptua gjerësisht se sa e rëndësishme është të jemi në gjendje të përshtatemi me mjetet, sistemet dhe proceset teknologjike dhe përpjekjet për të përgatitur brezin e ri me aftësitë e duhura të transferueshme "aftësitë e buta", të tilla si: komunikimi, aftësimi digjital, mendimi kritik, krijimtaria, zgjidhja e problemeve, bashkëpunimi, fleksibiliteti, iniciativa, udhëheqja, puna në grup, vetëbesimi, etj. që do të aftësojnë dhe përgatisin të rinjtë drejt tregut të punës.

Është e rëndësishme të theksohet se të gjitha sfidat, mangësitë, problematikat e hasura përgjatë vitit 2021 do të adresohen në mënyrë që efektet e tyre të minimizohen. Gjithashtu, do të adresohen të gjitha sugjerimet, opinionet, mendimet e aktorëve të përfshirë, më konkretisht sipas objektivave prioritare për vitin në vijim.

Në kuptim të sa më lart, angazhimi ynë drejt teknologjisë dhe inovacionit, nxitja e të rinjve në zhvillimin e sipërmarrjeve, si mjete për zhvillimin socio-ekonomik të cilat do të shërbejnë në zgjidhjen e sfidave aktuale sot në Shqipëri dhe uljen e papunësisë, do të jenë në pikësynimet e programeve tona si edhe në prioritetet e financimit nga AKR.

Fokus të shtuar do të ketë eksplorimi i mundësive për mbështetjen e të rinjve, nëpërmjet rritjes dhe fuqizimit të bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile me fokus të rinjtë, partnerëve dhe donatorëve me qëllim përthithjen e fondeve të huaja.

Synimet e vitit 2022 përfshijnë vijimin e shkollës verore, shkollës dimërore dhe trajnimeve nëpërmjet programeve afat-shkurtra dhe afat-mesme duke përfshirë edukimin jo-formal, arsimimin profesional, edukimin artistik-kulturor, forcimin e kapaciteteve, promovimin e të rinjve dhe mundësitë për të rritur pjesëmarrjen aktive të të rinjve duke shpenzuar kohë më cilësore në fusha të ndryshme profesionale si arti, sporti, zejet, edukimi etj.

Gjithashtu do të vijojë mbështetja për njësitë e vetëqeverisjes vendore në themelimin dhe funksionimin e Këshillave Rinorë Vendorë si edhe kontributi në hartimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029.

Të gjitha këto, së bashku me nxitjen e bashkëpunimit në kuadër të programit “Tirana Qyteti Evropian i Rinisë 2022”, do jenë lokomotiva e zhvillimit të rinisë dhe e formimit të gjeneratës së re shqiptare, një gjeneratë të cilës do t’i ofrohet çdo mundësi për formësim evropian.

Tiranë 2021